

RITJA E CILËSISË - SFIDA AKTUALE E AUDITIMIT

*nga Xhafer XHOXHAI - Drejtor Departamenti¹, Gjovalin PREÇI – Kryeauditues²,
botuar në gazetën “Ekonomia”, më 19 janar 2014.*



Nisur nga misioni i veprimtarisë së Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për vitin 2013 ka pasur në program realizimin e 31 auditimeve dhe ka arritur në plotësimin e kësaj detyre duke i evaduar plotësisht gjatë kësaj periudhe, të cilët ju përkasin 14 shoqërive publike (përfshirë dhe ente, institucione, autoritete etj.), 10 projekteve me financime të huaja, 5 ente mjedisore si dhe zbatimi i rekomandimeve për vitin 2012. Gjithashtu, me synim ruajtjen dhe avancimin e ritmeve të auditimit, krahas cilësisë së tyre, audituesit e Departamentit janë të angazhuar në tre subjekte për llogari të programit të viti 2014: dy projekte dhe një ent publik.

Rezultatet e auditimeve të kryera kanë evidentuar nevojën e rekomandimit të masave për përmirësime të kuadrit ligjore, për mirëmenaxhimin e aktivitetit nëpërmjet masave organizative, për parandalimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës në keqadministrimin e fondeve dhe pasurisë publike dhe procedurave të prokurimit, duke i kërkuar Agjencisë së Prokurimit Publik marrjen e masave administrative dhe autoriteteve respektive të subjekteve dhënin e masave disiplinore, si dhe në rastet e shpërdorimit të detyrës nuk kanë munguar dhe kallëzimet penale. Në mënyrë të përmbledhur janë 882 masa të rekomanduara, për 31 subjektet e audituara: 6 përmirësime ligjore, 523 çështje organizative, 50

rekomandime për shpërblim dëmi dhe 303 masa disiplinore dhe administrative, si më poshtë:

a) Përmirësimet ligjore janë rekomanduar në 4 subjekte dhe kanë të bëjnë kryesisht me ndryshime në bazën ligjore të aktivitetit të Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik, për kryerjen me efektivitet të shpenzimeve për mirëmbajtjen e ndërtesave të ambasadave jashtë vendit; mospërputhje të akteve nënligjore me ato ligjore apo të përmirësimeve të nevojshme, kur aktet rregullatore janë të nxjerra mbi bazën e ligjeve të shfuqizuara etj.

b) Masat organizative janë rekomanduar për 29 subjekte, të cilat përfshijnë të gjithë aktivitetin tërësor të subjekteve të audituara: bazën ligjore të funksionimit, aktivitetin ekonomik, veprimtarinë financiare, administrimin e marrëdhënieve të punës, funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm etj., kryesisht në shoqëritë publike, por edhe në projektet me financime të huaja dhe më pak në entet mjedisore. Është e rëndësishme të vihet në dukje, se audituesit nuk kanë qenë të prirur “për të dhënë sa më shumë masa”, por sipas gjetjeve të auditimit, ti rekomandohen subjektit rrugët e përmirësimi të treguesve ekonomik dhe financiar. Me gjithë punën e bërë në drejtim të formulimit dhe afatit për zbatim të masave organizative, vërehet se mbetet akoma për të bërë në drejtim të cilësisë së tyre, që të kuptohen dhe zbatohen sa më mirë dhe në afate të përshtatshme nga subjektet e audituara.

c) Nga auditimet kanë rezultuar 19 subjekte me pasojë dëm ekonomik, për të cilët është rekomanduar shpërblimi i dëmit në shumën 1,867,930,6 mijë lekë. Për 9 projekte me financime të huaja nga 10 të audituar, është rekomanduar zhdëmtimi i vlerës prej 94,930.6 mijë lekë dhe shuma e tjetër e dëmit prej 1,773,000 mijë lekë i përket zbulimeve në entet publike.

Duke analizuar dëmin ekonomik sipas fushave të evidentuar rezulton se zëri “të tjera” është në pjesën më të madhe, si rezultat i vlerës së sasisë së gazit dhe naftës brut të prodhimit paraekzistues të kompanive që veprojnë sipas marrëveshjeve hidrokarbure, të pa dorëzuar shoqërisë Albpetrol Sha. Në vijim janë dëmet në fushën e prokurimeve, kryesisht për likuidim të punimeve të pakryera, penalitete për vonesa në zbatimin e detyrimeve kontraktore etj. Pothuajse në të njëjtin nivel janë dhe dëmet e rezultuara në fushën e tatim taksave të konstatuar nga mos

derdhja e tatimit në burim, nga subjekte të huaja që operojnë në vendin tonë, kryesisht në shërbimet e konsulencës.

Duhet theksuar se vlerat e mësipërme të dëmit, janë pranuar nga subjektet dhe në pjesën më të madhe janë në proces ekzekutimi, pasi është nxjerrë akti administrativ për kryerjen e ndalesave dhe kanë filluar arkëtimet tyre.

d) Janë rekomanduar 303 masa disiplinore dhe administrative (në kompetencë të APP) për 24 subjekte. Nisur nga parregullsitë e evidentuara në fushën e prokurimeve publike, si dhe bazuar në ligjin përkatës, i janë dërguar APP për vlerësim për masë administrative me gjobë ose dhënien e masave disiplinore 118 persona për përgjegjësitë e konstatuara dhe nga përgjigjet e ardhura, ka rezultuar se janë konfirmuar propozimet e dhëna, gjë që tregon për rritje të cilësisë së veprimtarisë audituese të çështjeve të prokurimit.

Për 24 subjekte, sipas shkallës përgjegjësisë së evidentuar nga auditimi është kërkuar marrja e masave disiplinore nga “vërejtje me shkrim” deri në “largim nga puna” për 185 punonjës të niveleve të ndryshme të stafeve drejtuese e menaxhuese. “Largim nga puna” është kërkuar për 35 persona ose pothuajse për 1/5 e tyre. Numri më i madh i masave disiplinore dhe administrative i është rekomanduar subjektit “Posta Shqiptare Sha” (44); Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik (31), në Projektin “Modernizimi i sistemit shëndetësor” (15) etj.

e) Nga auditimet e kryera, në tre subjekte: Trajtimi i Studentëve Sha Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Projekti “Modernizimi i sistemit shëndetësor shqiptar” janë konstatuar elementë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, mashtrimit dhe të veprimtarisë kundërligjshme për 20 persona, të cilët janë kallëzuar penalisht.

KLSH ka praktikuar njoftimin e DAP për 13 persona në 5 subjekte, të cilët kanë rezultuar se nuk kanë qenë në marrëdhënie pune, për të rekomanduar masa disiplinore ndaj tyre, si dhe në një rast i është drejtuar IDKP për vlerësimin e konfliktit të interesit për një zyrtar të Ministrisë së Transporteve.

Parë në tërësi, gjetjet dhe rekomandimet për subjektet e audituara gjatë vitit që sapo lamë pas, i kanë shërbyer rritjes së prestigjit të KLSH para opinionit publik, si dhe vlerësimeve të Komisionit Evropian në Raport-Progresin e fundit se Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përmirësuar performancën e tij.

Është verifikuar shkalla e realizimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH për subjektet, dosjet e të cilave kanë plotësuar afatin e përgatitjes së planit të masave për realizimin e tyre. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se, në përgjithësi, është zbatuar afati për hartimin e programit të masave për zbatimin e rekomandimeve; masat organizative janë realizuar 82.3%, ato disiplinore 91.5 %; si dhe subjektet kanë filluar procedurat për zhdëmtimin e shumës prej 1,833,119.6 mijë lekë.

Krahas veprimtarisë audituese një vëmendje të veçantë ju është kushtuar shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të ardhura në KLSH, duke ju kthyer përgjigje ose marrë në konsideratë duke gjatë procesit auditues 29 kërkesë ankesa, nga të cilat 18 për çështje të administrimit financiar dhe prokurimeve dhe pjesa e tjetër për çështje ndryshme. Marrja, shqyrtimi, analiza dhe trajtimi me seriozitet dhe në afat i kërkesave të qytetarëve ka qenë një ndër objektivat e veprimtarisë së Departamentit tonë, krahas asaj audituese, e shpjeguar kjo dhe me faktin e rritjes së numrit të kërkesë ankesave të trajtuara.

Në kuadër të transparencës me publikin dhe rritjen e përgjegjësisë audituese nuk ka munguar dhe aktiviteti mediatik i këtij Departamenti. Bazuar në Urdhrin e Kryetarit të KLSH mbi botimet për aktivitetin e KLSH në shtypin e përditshëm, kanë qenë të pranishëm me artikujt e tyre pjesëtarë të Departamentit tonë, duke dhënë një kontribut modest në ngritjen e rolit dhe të prestigjit të institucionit tonë përballë opinionit publik nëpërmjet 15 shkrimeve në gazeta të përditshme të ndryshme. Gjithashtu, audituesit e departamentit kanë marrë pjesë në aktivitetet për dy konferencat shkencore të KLSH: “87 vjet KLSH në 100 vjet shtet shqiptar” dhe “Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme”, duke qenë pjesë aktive e kësaj të fundit.

Kryerja e veprimtarisë audituese mbi përdorimin efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, miradministrimi financiar dhe zbatimi i ligjshmërisë në fushën ekonomike e financiare ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme kualifikimin dhe trajnimin e audituesve. Rezultatet e arritura gjatë vitit 2013 janë frut i rritjes së performancës së audituesve nëpërmjet trajnimeve, duke realizuar mesatarisht 20 ditë trajnime për secilin auditues në fusha të ndryshme si Vlerësimi i riskut, Standartet e INTOSAI-t, Menaxhimi financiar dhe kontrolli, Materialiteti dhe risku, Auditimi i prokurimeve publike etj., brenda KLSH dhe jashtë vendit nga SAI homologe apo institucione të rëndësishme si CEF etj.

Me gjithë arritjet nga veprimtaria e Departamentit gjatë vitit 2013, zhvillimet aktuale dhe të perspektivës kërkojnë intensifikim të veprimtarisë audituese, duke e harmonizuar mirë me cilësinë e auditimit. Thellimi në analizën e rriskut për subjektet që do të auditoen dhe brenda tyre përcaktimi i fushave prioritare, do ta bëjë më efektive dhe rezultative punën tonë kontrolluese.

Veç kësaj, përmirësimi i dokumenteve të raportimit të auditimit kërkon në mënyrë të vazhdueshme studimin dhe përdorimin në praktikë të tyre, duke mos e konsideruar asnjëherë si një proces të përfunduar, por që kërkon një përkujdesje të veçantë.

Audituesit tanë janë të ndërgjegjshëm, se nuk mund të arrihen auditime cilësore, pa njohur mirë bazën ligjore të funksionimit të subjektet të audituar, aq më tepër e nevojshme kjo kur ne kryejmë auditime të përputhshmërisë: rregullshmërisë dhe ligjshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare. Në këtë mënyrë mund të arrihet në konkluzione të qarta mbi bazën e një evidence të grumbulluar dhe të analizuar mirë.

Ndryshimet e në dokumentet standarde të raportimit kanë rritur përgjegjësinë e audituesit për gjuhën dhe mënyrën e paraqitjes së raporteve: përshkrimin e çështjes së audituar, gjetjet dhe përgjegjësitë përkatëse, aq më tepër që dhënia e një pjese të rekomandimeve që në fazën e projektraportit, bën që auditimi të jetë i “gjallë” që nga momenti i nisjes dhe deri në zbatimin e tyre. Kjo kërkon një punë të kujdesshme të secilit prej nesh, që nga hartimi i programit të auditimit dhe deri në evadimin e dosjes së auditimit.

Krahas këtyre, veprimtaria audituese kërkon që të zbatohet rreptësisht kodi i etikës, në një figurë të pastër të audituesit, zbatim të disiplinës në punë, komunikim korrekt me subjektin, midis nesh dhe me eprorët tanë. Kjo do të jetë edhe pjesë e sfidave tona në të ardhmen.

Arritjet e mësipërme janë një bazë e shëndoshë për të përballuar sfidat e auditimit në kushtet e reja të zhvillimit ekonomik dhe financiar të vendit, pritshmëritë e parlamentit dhe të opinionit publik, për të çuar më tej vlerat themelore të Kontrollit të Lartë të Shtetit: pavarësinë dhe objektivitetin, kompetencën dhe kujdesin, bashkëpunimin dhe sinqeritetin, ndershmërinë dhe integritetin, të cilat do të jenë të mishëruara në formimin dhe veprimtarinë e audituesve tanë. Kjo do të ishte e pamjaftueshme në se nuk do të shoqërohet me një monitorim të rreptë, të

gjithanshëm dhe të vazhdueshëm të të gjithë treguesve për një auditim dhe auditues të shëndetshëm dhe bashkëkohor.

¹ Shkrime të tjera të botuara nga Xhaferr XHOXHAI për periudhën Janar–Qershor 2014:

- *KLSH dhe kërkesa për menaxhimin shtetëror të përgjegjshëm.*

(Botuar në gazetën “Koha jonë”, më 14 maj 2014.)

² Shkrime të tjera të botuara nga Gjovalin PREÇI për periudhën Janar–Qershor 2014:

- *Kontrrolli i Lartë i Shtetit dhe kontrolli i administrimit tatimor.*

(Botuar në gazetën “Ekonomia”, më 14 maj 2014 dhe në gazetën “Tirana Observer”, më 21 maj 2014.)

- *KLSH dhe auditimet e performancës.*

(Botuar në gazetën “Tirana Observer”, më 21 maj 2014.)